



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 34

Datë: 29. 06. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017.
3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje. Kush është për këtë rend dite...? A ka dikush ndonjë propozim, ose ngjashëm...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017.

Valdete Daka: Menjëherë, vazhdojmë me rezultatet. A t'i lexoj unë, edhe një here? Statistikat janë këto: Numëri i votuesve të regjistruar 1872941 votues, ata që kanë votuar në secilin vendvotim: 747229. Jashtë vendvotimit me kusht, pra: 29957, pjesëmarrja në votime 41.50%, të vlefshme 728 0.87, të pavlefshme 42441, të zbrasta 6565 dhe të dëmtuara 1746. Këto janë pra statistikat. Po urdhëro.

Betim Gjoshi: Faleminderit që ma dhe fjalën. E para, d.m.th., te statistikat, i kemi disa anomali. E para e punës, 29 mijë e votuesve të cilët kanë votu jashtë vendvotimit me kusht VNPV dhe më post është pak. Kanë votuar më shumë në bazë të të gjitha raporteve që i kemi marr. I kemi pasur 52000 e sa që kanë votuar me post, kemi pasur 27000 e sa me kusht...Këtu, është numri i fletvotimeve të vlefshme që kanë qenë në këtë proces. Për, këtë po na del një mospërputhje. E dyta, mendoj që numëri i fletvotimeve të pavlefshme prapë është i vogël, krahasuar me atë që kemi parë në bazë të realitetit. Pastaj, edhe në qoftëse i mblidhni fletvotimet e pavlefshme dhe të vlefshmet, edhe nuk ja u japin numrin e fletvotimeve të përdorura...Edhe kjo është evidenete d.m.th. që është dashur të përputhet deri në mas të madhe pokemi shkarje ne numër mjaft të madh të votave. Unë kisha menduar që, ne është mirë që ose me dhënë rubrika më pak e ato me qenë të sakta, ose është mirë që këto rubrika të mblidhen edhe të japin shifra përafërsisht të sakta, se në qoftëse kemi pasur tolerancë ndoshta në ndonjë vendvotim, plus minus mund të luaj në të gjithë Kosovën 100-200 vota me nënshkrime se, as ajo nuk do të duhej të ndodhte por, si e tillë po, vazhdon me pas mospërputhje.

Unë, tha z. Gjoshi, po them se ndoshta sot mund të japim kështu si janë, por kur të vij puna të certifikohen rezultatet, është mirë m'i shikue këto, për këtë edhe paguhet një kompani e tërë që e ka për detyrë ti barazoj këto raste. Se, edhe ne është mirë ndonjëherë ti themi dikujt ndonjë fjalë të saktë se, i kemi dhënë disa informata. Kemi thënë njëherë që, i kemi 31 mijë vota me kusht, por e kemi parë që nuk kanë qenë 31 mijë, por 25 mijë: 2 mijë me nevoja të veçanta, 5 mijë nga diaspora, bile po dalin 33 mijë në këtë variantin që ne jemi marrë me to... Tash, nëse japin 29 mijë, i bie që kemi treguar të vërtetën gjatë gjithë kohës. Njëjtë është edhe te kjo pjesa e fletvotimeve d.m.th., të pavlefshme, pastaj edhe këtë kategorinë që e di që asgjë nuk kemi marr por, këtë kategorinë e fletvotimeve të zbrasta, ne duhet ta eliminojmë prej terminologjis. Ligji e thotë saktë se kur nuk dihet vullneti i votuesve, është fletvotim i pavlefshëm, nuk ka tjetër kategori më, ky është zbulim që ne e kemi bërë edhe anojmë edhe punën tonë.

Pastaj, tha z. Gjoshi, unë kamë parë (nuk e di qfar kanë bërë ne vendvotim) në QNR-ë çka shpallshin fletëvotim të zbrazët, ajo ka qenë absurde: fletvotimet që kanë votuar kandidat, e nuk e kanë votuar subjektin i shpallshin të zbrazët por, ai nuk është i zbrazët...Votuesi ka votuar, pse ai nuk ka ditur të votoj është muhabet krejt tjetër....Do të thotë, nuk më është dukur procedura e mirë..Unë, mendoj edhe njëherë me i rishikuar deri në ora 2 kur i publikojmë..përndryshe, unë nuk prishi punë! Unë, kam për të votuar që të miratohen rezultatet...

Burim Ahmetaj: A mundem vetëm një shpjegim ta bëjë? Te rubrika ku i referohet numrit të votuesve të cilët kanë votuar me kusht, me postë dhe me nevoja të veçanta, totali i votave me kusht dhe me nevoja të veçanta ka qenë dikund 2700, dikund rreth 2600 vota janë refuzuar që i bije, dikund 2400 vota të vlefshme me kusht edhe me nevoja të veçanta, plus votat me post 5246, na japin gjithë totalin 29157...

Betim Gjoshi: Unë shumë i qartë isha që rubrika ku po flasim po flet për personat që kanë votuar jashtë vendvotimit nuk pata për vota të vlefshme, votat e vlefshme i kemi më poshtë...

Burim Ahmetaj: Kështu i referohet ligji...

Betim Gjoshi: Jo, jo ligjit nuk i referohet, ligji i referohet kush ka votuar, se 747 mijëshi në vendvotim të rregullt ka prej tyre që janë vota të pavlefshme, d.m.th., të jemi të qartë: e ke rubrikën për këta 728 mijë më vonë...

Valdete Daka: Ndoshta kishte qenë mirë me e shënuar, me i nda...

Betim Gjoshi: Këto votat të vlefshme - të pavlefshme që kanë ardhur nga kjo kategori ose duhet me tregu që këto janë vetëm fletvotimet e vlefshme nga këto kategori...

Sami Hamiti: Kryetare, edhe te statistikat e votat e pavlefshme, e përmendi edhe Betimi, në statistika ke 52500 që janë të pavlefshme tash janë 42 mijë, po i morëm edhe këto të zbrazëta bëhen 48-49 mijë... por mbesin 3500...! A janë bërë të vlefshme ato vota çka ka ndodhur...? 52500 i kemi në statistika...! A kanë qenë raportime të gabueshme apo çka ka ndodhur me 3000 vota...? Në anën tjetër: A i keni përpunuar me dorë këto rezultate? Me dorë i keni punuar sepse, firma që e keni të angazhuar nuk ka mundur t'i qes rezultatin deri më tash, duhet të rishikohen...

Valdete Daka: A vazhdojmë me rezultatet, nëse nuk kemi diçka tjetër...?

Sami Hamiti: Pa i barazuar ato, mos të dalim qesharak, se të parën e kemi pasur 52500 ku kan shkuar ato vota, duhet me tregu mos të dalim qesharak ne pas dy ore. Në të gjitha mediat e ke pasur 52500 ku mbetën u bënë të vlefshme ato.

Valdete Daka: Gjitha këto informata janë prej sistemit kështu që nuk mund të them, mirëpo ato që i kemi vërtetuar janë 72887 fletvotime të vlefshme që janë vota për subjekte politike.

Valdete Daka: Atëherë, rezultatet e subjekteve. Kualicioni PAN: 33.74%, Levizja Vetëvendosje: 27.49%, të gjithë votave, LDK kualicioni LDK-AKR: 25.53%. Lista Serbska: 6.12%, Fjala: 1.10%, PDTP-ja 1.08%, Kualicia Vaka 0,89%, Nova Demokracka Stranca 0.49%, Esoles 0,49%, Partia Demokratike e Ashkalinjve 0.33%, Partia Liberale Egjiptiane 0.33%, Edisena Goranska Partia 0.33%, Partia Kosovski Serba Aktivna Gradanska Iniciativa 0.29%, Prtia e ashkalive 0.29%, PDS-i 0.23%, Inicativa e Re Demokratike 0.21%, KTAP 0.20%, Kualicioni SDA 0.19%, Pokretzagoro 0.14%, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës 0.13%, Kosova Kinemi Romani Partia 0.13%, Graxhancka Iniciativa Gore 0.11%, Partia Demokratike e Unitetit 0.07%, Prosperitezka Kosova 0.04%, Eromendie Alternativa 0.03%, Enaprenasnaga Kosova 0.03% a janë këto në rregull? A ka dikush vërejtje në këto? Nëse jo vazhdojmë me DPK-ët dhe me ulset e fituara. Kualicioni PAN 39 ulëse, Lëvizja Vetvendosje 32, LDK 29 Ulëse, Sërbska Lista 9 ulëse, Kosova Demokratik Tyrk Parti 2, Kualicioni Vaka 2, NDS-i 1, SLS-i 1 ulëse, Partia Demokratike e Ashkalinjve 1 ulëse, Partia Liberale Egjiptiane 1 ulëse, Edisena Goranska Partia 1 ulëse, Partia e Ashkalinjëve për Integrim 1 ulëse dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës 1 ulëse. Ndërkaq, deputetët nuk ka nevoj ti lexojmë. Këto janë pra, emrat i keni. Nëse nuk ka dikush vërejtje tjera edhe në qoftëse mundemi mi përmirsuar këto? Kush është për miratimin e këtyre rezultateve, kush është kundër, kush apstenon? Me një apstenim, faleminderit...

Për KOZ

Valdete Daka, kryetare
